



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	24.03.2026	02.04.2026	2026/0163

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.03.2026, OE “HC STORE SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0163, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Beni Dona”, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me artikuj ushqimor - Lot 3 dhe Lot 5” me nr. të prokurimit: "201/26300-25-11214-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit .Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: furnizim, vlera e parashikuar e kontrates: 1,340,000 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve

Neni 68.4 Gjendja Ekonomike dhe Financiare

Neni 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Neni 61.3 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores

Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Në cilësinë e Grupit të Operatorëve Ekonomik (GOE) për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me artikuj ushqimor", Lot 5, paraqesim kërkesën për rishqyrtim të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të publikuar më 27.02.2026.

Kjo ankesë parashtrohet kundër vendimit për eliminimin e ofertës sonë, me arsyetimin e dhënë nga AK lidhur me Deklaratën për Themelimin e Grupit dhe 3/12

dokumentin e përkrahjes bankare.

Arsyetimi i AQP

Ju jeni eliminuar për arsye : është vlerësuar që nuk ka plotësuar kërkesën administrative lidhur me DEKLARATEN PER THEMELIM TE GRUPIT ku tek pika 5 e kesaj deklarate paraqiten vetem dy anetare te grupit qe kane % (perqindjen) e pjesemarrjes ne realizimin e kontrates ne raportet 75% me 25%, ndersa nje anetare i grupit nuk figuron fare tek perqindja e pjesemarrjes ne realizimin e kontrates, pra nje anetare i grupit figuron qe nuk ka fare pjesemarrje ne realizimin e kontrates por ka vetem pergjegjesin sic eshte cekur ne kete deklarate citojme: "Po ashtu N.P.T. AL -VIS (Fehmi Cakiqi B.1.) merre persiper si anetar i grupit te nxjerre leter perkrahese kredie nga ndonje bank e licensuar ne emer te tenderit te publikuar nga AQP-ia.", me kete rast ne fakt kredia per kete OE nuk ploteson kushtin per te cilin eshte kjo kerkese qe eshte me qellim qe kontraktuesi te kete likuiditet/mjete financiare per fillimin dhe realizimin e kontrates pa probleme. Gjithashtu edhe tek ky OE eshte vlerësuar që Letra e References nuk plotëson kërkesën e dosjes së tenderit pasi që ne të ceket citojme: "(emri i bankes) do të konsiderojë mbështetjen financiare duke u bazuar në kapacitetin e tij financiar pas analizës

financiare te bere nga analistet tane te kredive per shumen e kerkuar ... ", pra pervec qe ky dokument eshte i leshuar per anetarin e grupit qe nuk pjesemarrje ne realizim te kontrates gjithashtu nuk eshte e leshuar sipas kerkeses se dosjes se tenderit ku kerkohet qe te jete qasje e pakushtezuar. Ndersa ne nje dokument tjeter per liderin e grupit eshte deshmuar qe me daten 29.12.2025 qe ka pasur mjete financiare ne nje vlere qe nuk ploteson kushtin prej minimum 200,000€ sic eshte kerkuar per Lot 2 ndersa per Lot I ky ofertues nuk eshte oferta me cmimin mete lire.

Pretendimi 1 - DEKLARATEN PER THEMELIM TE GRUPIT

Eliminimi bazuar në arsyetimin se deklarata e themelimit te grupit nuk eshte plotesuar si duhet pasi qe ne DEKLARATEN PER THEMELIM TE GRUPIT tek pika 5 e kesaj deklarate paraqiten vetem dy anetare te grupit qe kane % (perqindjen) e pjesemarrjes ne realizimin e kontrates ne raportet 75% me 25%, ndersa nje anetare i grupit nuk figuron fare tek perqindja e pjesemarrjes ne realizimin e kontrates por ka vetem pergjegjesin te nxjerre leter perkrahese kredie nga ndonje bank e licensuar ne emer te tenderit te publikuar nga AQP-ia.

Konsiderojmë se vendimi është marrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik, pasi qe:

Ne kemi dorëzuar ofertë si grup operatorësh ekonomikë: "Grup Operatorëve Ekonomik

1. HC STORE SH.???.;
2. ??? SH.P.K.;
3. Fehmi Cakiqi B.?

i

Në Deklaratën e Themelimit të Grupit të Operatorëve Ekonomik, tek pika 5, janë përfshirë vetëm keta dy anëtarë me përqindjet e pjesëmarrjes operative në realizimin e kontratës: 75% dhe 25%.

Të dy anëtarët e përfshirë në përqindjen operative janë të përcaktuar qartë në

Deklaratën e Themelimit të Grupit, ndërsa GOE është mbështetur në kapacitetin financiar të Fehmi Cakiqi B.I. (N.P.T. AL-VIS) i cili ka rol të

qartë brenda strukturës së grupit.

Sipas Nenin 68.4 të LPP-së: "Një operator ekonomik mund, kur është ? përshatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ai ka me ta. Ai duhet në këtë rast të dëshmojë për autoritetin kontraktues se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme... Në kushte të njëjta, një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështeten në kapacitetet e pjesëmarrësve në grup ose të subjekteve të tjera."

Nga kjo dispozitë rezulton qartë se:

Mbështetja në kapacitete të tjera është e lejuar;

Kushti i vetëm është dëshmimi i disponueshmërisë së burimeve për ekzekutimin e kontratës.

KRPP, në interpretimin zyrtar nr. 18 të datës 22.11.2022, ka sqaruar:

"Një operator ekonomik mund të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera për përmbushjen e kërkesave financiare ose teknike dhe nuk mund të diskualifikohet pse nuk ka marrë pjesë si grup i operatorëve ekonomik."

Prandaj, eliminimi për shkak të mungesës së përqindjes operative bie ndesh me nenin 68.4 dhe interpretimin zyrtar të KRPP, pasi përgjegjës për ekzekutimin e kontratës është grupi, dhe jo subjekti pa pjesëmarrje operative.

Në rastin konkret nëpërmjet letrës bankare të OE N.P.T. AL-VIS (Fehmi Cakiqi B.I.) kemi dëshmuar për autoritetin kontraktues se do të kemi në dispozicion burimet e nevojshme.

Interpretimi zyrtar i KRPP-se nr. 18 të datës 22.11.2022:

"Një operator ekonomik mund të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera për

përmbushjen e kërkesave financiare ose teknike dhe nuk mund të diskualifikohet pse nuk ka marrë pjesë si grup i operatorëve ekonomik." Gjithashtu është theksuar se: "Është e drejtë e çdo operatori ekonomik të mbështetet në kapacitetet e një subjekti tjetër; dallimi qëndron vetëm tek përgjegjësia për ekzekutimin e kontratës." Prandaj, eliminimi për shkak të mungesës së përqindjes operative bie ndesh me interpretimin zyrtar të autoritetit rregullator, respektivisht KRPP pasi që edhe sipas interpretimit të KRPP përgjegjës për ekzekutimin e kontratës është operatori ekonomik i cili mbështetet në kapacitetet e subjekteve tjera dhe si rrjedhojë në këtë rast Grup i Operatorëve Ekonomik HC STORE SH.P.K.; MEKA SH.P.K.; është përgjegjës për ekzekutimin e kontratës.

Në kemi dorëzuar ofertën në emër të 2 anëtarëve, kemi ndarë % e realizimit të kontratës, ndërsa N.P.T. AL-VIS vetëm ka siguruar mbështetjen bankare në përputhje me nenin 68.4 të LPP. Prandaj eliminimi mbi bazën e % është në kundërshtim me nenin 68.4 të LPP dhe interpretimin e KRPP. N.P.T. AL-VIS (Fehmi Cakiqi B.I.) ka rol të qartë brenda strukturës së grupit, por nuk kryen pjesëmarrje direkte në realizimin e kontratës.

18. 22.11.2022 A lejohet një kompani të mbështetet në kapacitetet e degëve të saja, apo duhet të marrë pjesë vetëm si grup i operatorëve ekonomik?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për

Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron

interpretimin ligjor, si në vijim:

Në përputhje me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së, një operator ekonomik për tu konsideruar i përgjegjshëm nga autoriteti kontraktues, duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Paragrafi 4 i nenit 68 i LPP-së lidhur me Gjendjen ekonomike dhe financiare, përcakton:

"4. Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta. Ai duhet në këtë rast të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete për këtë qëllim. Në kushte të njëjta, një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështeten në kapacitetet e pjesëmarrësve në grup të subjekteve të tjera".

gjithashtu,

Paragrafi 8 i nenit 69 të LPP-së lidhur me Aftësitë teknike dhe/ose profesionale, përcakton:

"8. Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta. Ai në këtë rast duhet të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete në vend burimet e nevojshme në dispozicion të operatorit ekonomik. Nën të njëjtat kushte një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose në subjekte të tjera". ndërsa,

Paragrafi 4 i nenit 71 të LPP-së lidhur me Grupin e operatorëve ekonomik, përcakton: "4. Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit".

Në përputhje me dispozitat e lartë cituara, në rast se një operator ekonomik i cili operon me degët e saja në disa vende (shtete) të tjera, mund të mbështetet në kapacitetet e degëve të saja për ti përmbushë kërkesat lidhur gjendjen ekonomike dhe financiare apo lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale duke ofruar me tender dëshmitë përkatëse dhe për këtë qëllim nuk mund të diskualifikohet i njëjti pse nuk ka marrë pjesë si grup i operatorëve ekonomik.

E pa pranueshme do të konsiderohej nëse operatori ekonomik me degët e saja dorëzojnë individualisht tenderë në një aktivitet prokurimi që ka për qëllim dhënien e një kontrate publike, sepse një pjesëmarrje e tillë do të dëmtonte konkurrencën, në fakt do të krijonte konkurrencë të pa ndershme.

Gjithnjë në përputhje me dispozitat e lart cituara, është e drejtë e çdo Operatori Ekonomik i cili nuk mund ti përmbushë si i vetëm

kërkesat e parashtruara në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë lidhur me gjendjen ekonomike dhe financiare apo lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, të mbështetet në kapacitetet e një subjekti (ve) tjetër, apo të marrë pjesë në grup të operatorëve ekonomik (konzorcium). Dallimi qëndron vetëm tek përgjegjësia. Në rastin e mbështetjes, përgjegjës për ekzekutimin e kontratës është operatori ekonomik i cili mbështetet në kapacitetet e subjekteve tjera, ndërsa në rastin e Grupit të Operatorëve Ekonomik, grupi është individualisht dhe bashkërisht përgjegjës për ekzekutimin e kontratës.

Për më tepër, neni 71 i LPP-së, që rregullon grupet e operatorëve ekonomik, nuk kërkon që çdo anëtar i grupit të ketë domosdoshmërisht një përqindje të përcaktuar të realizimit të kontratës. Ky nen vetëm përcakton se:

çdo kërkesë për kapacitet financiar, teknik apo profesional aplikohet ndaj grupit si tërësi, dhe jo ndaj secilit anëtar individualisht.

Prandaj, fakti që një anëtar i grupit nuk ka përqindje të realizimit të kontratës nuk

mund të jetë bazë për eliminim, përderisa grupi si tërësi plotëson kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit.

Bazuar në sa më sipër:

eliminimi i ofertës sonë për shkak të mungesës së përqindjes së pjesëmarrjes për një anëtar të grupit është në kundërshtim me nenin 68.4 dhe nenin 71 të LPP-së:

vendimi është gjithashtu në kundërshtim me interpretimin zyrtar të KRPPsë nr. 18 të datës 22.11.2022;

grupi i operatorëve ekonomik ka dëshmuar disponueshmërinë e burimeve financiare të kërkuara nga dosja e tenderit

Pretendimi 2 - Dokumenti i përkrahjes bankare nuk përmbush kërkesën për kapacitet financiar

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar që operatori ekonomik të dëshmojë kapacitet financiar për realizimin e kontratës përmes:

mjeteve të gatshme në bankë, ose

mbështetjes bankare / qasjes në kredi për realizimin e kontratës.

Ne, si Grup i Operatorëve Ekonomikë (GOE), siç është cekur më lartë, kemi mbështetur ofertën tonë në kapacitetin financiar të N.P.T. AL-VIS dhe kemi dorëzuar letër përkrahjeje bankare të lëshuar nga institucion bankar i licencuar, si dëshmi mbështetjes financiare për realizimin e kontratës.

Pavarësisht dorëzimit të këtij dokumenti, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar ofertën me arsyetimin se:

e

"Letra e References nuk përmbush kërkesën e dosjes së tenderit pasi në të ceket se do të konsiderojë mbështetjen financiare duke u bazuar në kapacitetin e tij financiar pas analizës financiare të bërë nga analistët tanë të kredive për shumën e

kërkuar Ne kemi dorëzuar mbështetje bankare në përputhje të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit, duke dëshmuar qartë se posedojmë mjete për realizimin e kontratës. Kjo plotëson objektivin ligjor të kriterit, që është sigurimi i kapaciteteve financiare për fillimin dhe realizimin e kontratës pa pengesa.

Forma e dokumentit është sipas procedurave standarde të bankës dhe nuk mund të lëshohet në format tjetër; prandaj, mospranimi i tij për arsye formale është i padrejtë dhe disproporcionale. Institucioni bankar ka format dhe procedurat e veta të miratimit dhe nuk mund të lëshojë dokument tjetër jashtë këtyre rregullave. Kjo është praktikë standarde në sektorin financiar dhe nuk mund të interpretohet si mangësi nga ana e operatorit ekonomik.

Në rast paqartësie, Autoriteti Kontraktues ka pasur obligim ligjor të kërkojë konfirmim nga banka lëshuese, në përputhje me procedurat e parashikuara në LPP dhe praktikat e OSHP-se.

Në rast se Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar se dokumenti i përkrahjes bankare nuk është i mjaftueshëm ose nuk përmbush formalisht kërkesën, atëherë kemi dëshmi shtesë për mjete të gatshme në bankë në vlerë prej 200,000 euro.

Bashkangjitur gjeni dokumentin që dëshmon se posedojmë mjete të gatshme për implementimin e kontratës.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtuar nga OE “HC STORE SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me artikuj ushqimor - Lot 3 dhe Lot 5” me numër të prokurimit: “201/26300-25-11214-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit

ProCredit Bank Sht.A. Zyra Qendrore – Rr. Xhevdet Bushi, Nr.28, 10 000 Prishtinë, Kosovë

VËRTETIM PËR KLIEN TË PCBK-A

Më kërkesë të, **FEHMI ÇAKIÇI B.I.**, në konfirmojmë se klienti në fjale është klient i ProCredit Bankes dhe vë nënshkrimin me poshtë:

Emri i Regjistrimit:	FEHMI ÇAKIÇI B.I.	NPT AL - VIS
Numri i Regjistrimit:	XK051162664772000137	
Numri Unik Identifikues:	810247788	
Dilanci në dispozicion me datë 10.02.2026:	EUR 236,037.62	

Nëse keni pyetje të tjera, ju lutemi të na kontaktoni.
Sinqerisht,
Mentor Haxhiu, PCB KOS

Data: 10.02.2026

ProCredit Bank Sht.A.
Rr. Xhevdet Bushi, Nr. 28
10 000 Prishtinë
Kosovë

Telëfoni: +383 (0) 38 / 555 777
Fax: +383 (0) 38 / 555 778
www.procreditbank-kos.com

Numri Unik Identifikues: 810247788
TVSH Nr. i Identifikimit: 300001793
Nr. Regjist. 800016426

Banka AK
Udhëz. Pa
Baza CA

Në rast paqartësie, Autoriteti Kontraktues ka pasur obligim ligjor të kërkojë sqarim ose konfirmim nga banka lëshuese, në përputhje me mekanizmin e sqarimeve të paraparë në nenin 72 të LPP-së.

Në një vendim të mëhershëm për rast identik (OSHP: 2024/0352), Paneli Shqyrtues 8/12

ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të kërkojë informacione shtesë lidhur me referencat bankare dhe të veprojë sipas nenit 72 të LPP-së, duke kërkuar sqarime nga banka. Shih vendimin e bashkangjitur.

Ky qëndrim përbën praktikë të konsoliduar interpretimi dhe garanton siguri juridike dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Dokumenti i dorëzuar është deklaram profesional i një institucioni financiar të licencuar. Autoriteti Kontraktues ka interpretuar efektin financiar të dokumentit bankar pa kërkuar konfirmim nga banka, duke bërë vlerësim të natyrës bankare jashtë kompetencës së tij profesionale.

Interpretimi i kapacitetit kreditues dhe i qasjes në financim është çështje që mund të

sqarohet vetëm nga institucioni bankar përkatës. Mosshfrytëzimi i mekanizmit të sqarimeve sipas nenit 72 të LPP-së ka rezultuar në eliminim të padrejtë të ofertës sonë.

Interpretimi strikt formal i dokumenteve të lëshuara nga palë të treta cenon qëllimin themelor të prokurimit publik, i cili synon:

konkurrencë reale;

përzgjedhje të ofertës ekonomikisht më të favorshme;

trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë;

shmangien e pengesave administrative që nuk janë thelbësore për aftësinë operatorit ekonomik për të realizuar kontratën.

e

Prandaj, refuzimi i dokumentit të përkrahjes bankare, si dhe mos marrja parasysh e dëshmisë për mjete të gatshme në bankë në vlerë prej 200,000 euro, është i papranueshëm, i padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin, duke cenuar qasjen e operatorëve ekonomikë në konkurrencë të ndershme dhe përmbushjen e objektivit të prokurimit publik.

Neni 59 obligon Autoritetin Kontraktues që gjatë vlerësimit të tenderëve të sigurojë trajtim të barabartë, proporcionalitet dhe vlerësim substancial të dokumenteve të dorëzuara. Në rastin konkret, AK ka bërë një interpretim strikt formal të letrës së përkrahjes bankare, pa vlerësuar përmbajtjen dhe efektin real financiar të saj.

Dokumenti i dorëzuar dëshmon qartë ekzistimin e mbështetjes financiare dhe përmbushjen e qëllimit të kriterit - sigurimin e kapacitetit për realizimin e kontratës.

Eliminimi i ofertës për arsye që nuk cenojnë substancën e kriterit përbën shkelje të parimit të proporcionalitetit dhe të nenit 59 të LPP-së.

Neni 68 lejon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë kapacitetin financiar përmes mjeteve të gatshme ose përmes mbështetjes bankare / qasjes në kredi. Ne kemi dorëzuar:

Letër përkrahjeje bankare nga institucion i licencuar;

Dëshmi për mjete të gatshme në bankë në vlerë prej 200,000 euro.

Këto dokumente përmbushin plotësisht kërkesën e Dosjes së Tenderit dhe objektivin ligjor të kriterit financiar. Refuzimi i tyre për arsye formale, pavarësisht se dokumentojnë kapacitet real financiar, përbën interpretim të gabuar dhe aplikim të padrejtë të nenit 68.

ëse AK ka pasur paqartësi lidhur me formulimin e letrës bankare, ka qenë obliguar të përdorë mekanizmin e sqarimeve sipas nenit 72 të LPP-së dhe të kërkojë konfirmim nga banka lëshuese. Mosshfrytëzimi i këtij mekanizmi dhe eliminimi i menjëhershëm i ofertës përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 72. Interpretimi i kapacitetit kreditues është çështje profesionale bankare dhe nuk mund të vlerësohet në mënyrë të njëanshme nga AK pa kërkuar konfirmim nga institucioni financiar.

Autoriteti Kontraktues, duke eliminuar ofertën tonë për arsye formale dhe duke shpërblyer një operator ekonomik me çmim më të lartë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 të LPP-së, i cili përcakton se qëllimi i ligjit është sigurimi i mënyrës më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike.

Njëkohësisht, është shkelur edhe neni 6 i LPP-së, i cili obligon autoritetet kontraktuese të sigurojnë përdorimin më ekonomik të fondeve publike. Përzgjedhja e një oferte me çmim më të lartë, si rezultat i eliminimit të padrejtë të ofertës sonë, bie ndesh me parimin e ekonomicitetit dhe efikasitetit.

Për rrjedhojë, vendimi i AK-së cenon drejtpërdrejt interesin publik financiar dhe është në kundërshtim me qëllimin themelor të LPP-së.

Per me teper, në vendimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin e Kerkeses sonë, dokumentit të nxjerrë nga banka nuk i është dhënë fare trajtim, me arsyetimin se ky dokument nuk ka qenë pjesë e ofertës.

Ky qëndrim është i papranueshëm dhe tregon qartë se AK ka veprim vetëm për eliminimin e ofertës sonë, pa u marrë me vlerësimin e dokumenteve dhe pa marrë

parasysh qëllimin e ligjit, ndërsa oferta jonë ka qenë rreth 10,000 € më e lirë se oferta më konkurruese.

Sipas nenit 72 të LPP-së, çdo dokument i nxjerre nga operatori ekonomik para datës së hapjes së ofertave duhet të trajtohet dhe të vlerësohet nga Autoriteti Kontraktues, në mënyrë që të sigurohet përmbushja e kushteve të dosjes së tenderit. Në rastin konkret:

dokumenti i lëshuar është para datës së hapjes së ofertave;

ky dokument është pjesë e provës që grupi ynë ka kapacitet financiar të mjaftueshëm për realizimin e kontratës;

mosvlerësimi i tij bie ndesh me nenin 72 të LPP-së dhe me qëllimin e ligjit për sigurimin e konkurrencës dhe transparencës.

Për më tepër, ekzistojnë vendime të OSHP-së, të tilla si Vendimi 2025 0399.pdf, ku ankesa është refuzuar vetëm për arsye se dëshmitë nuk janë bashkangjitur se paku me ankese, por nuk ka vendime ku AK mund të refuzojë një dokument të dorëzuar në kohë të ligjshme dhe të ligjshëm si prova e disponueshmërisë financiare.

Prandaj, mosvlerësimi i vertetimit bankare nga AK përbën shkelje të hapur të nenit 72 të LPP-së, duke cenuar të drejtën tonë për trajtim të barabartë dhe konkurrencë të ndershme, dhe rrit dyshimet për qëllim të veçantë eliminimi të ofertës sonë.

Pretendimi 3 - Neni 61.3 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe

Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik Në përputhje me nenin 61.3 të Rregullores së Prokurimit Publik, Autoriteti

Kontraktues, përkatësisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, është i detyruar të publikojë Kërkesën për Rishqyrtim në Platformën e Prokurimit Elektronik, tek dosja e tenderit në seksionin "shto dokument shtesë".

Në këtë rast, AQP nuk ka përmbushur këtë detyrim ligjor, duke mos publikuar 2

Kërkesat për Rishqyrtim. Kjo përbën shkelje të parimeve të transparencës dhe integritetit, pasi mungesa e publikimit pengon palët e interesuara të kenë qasje në informacionin e nevojshëm për të ndjekur procedurat ligjore dhe për të ushtruar të drejtat e tyre.

Si rrjedhojë, kërkohet që OSHP të konstatojë këtë shkelje dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar që Autoriteti Kontraktues të respektojë detyrimet ligjore dhe të garantojë një proces të drejtë dhe transparent të prokurimit.

Pretendimi 4 - Shkelja e Qëllimit të LPP-së, Ekonomicitetit dhe Efikasitetit, si dhe Parimit të Barazisë në Trajtim / Jo-Diskriminimit (Neni 1, Neni 7 dhe Neni 59 i LPP-së)

Sipas Nenit 1 të Ligjit për Prokurimin Publik, qëllimi i këtij ligji është të sigurojë përdorim efikas, ekonomik dhe transparent të fondeve publike, ndërsa Neni 7 i

LPP-së obligon autoritetet kontraktuese të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Po ashtu, sipas Nenit 59 të

LPP-së, autoriteti kontraktues është i obliguar që gjatë procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve të veprojë në mënyrë objektive dhe në përputhje të plotë me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka shpërblyer operatorin ekonomik Beni Dona Plast SH.P.K. me ofertë në vlerë 1,189,675.00 €, ndërsa oferta e Grupit të Operatorëve Ekonomik HC STORE SH.P.?.; ??? SH.P.K.; Fehmi Cakiqi B.I., në vlerë 1,179,875.00 €, është eliminuar nga procedura.

Nga kjo rezulton se është shpërblyer një operator ekonomik me çmim 9,800.00 € më të lartë, përkundër faktit se oferta jonë është më ekonomike dhe në përputhje me interesin e përdorimit racional të fondeve publike. Një veprim i tillë bie ndesh drejtpërdrejt me parimin e ekonomikitetit dhe efikasitetit të përcaktuar në LPP.

e

e

Për më tepër, ekzistojnë dyshime serioze lidhur me përputhshmërinë mbështetjes bankare të operatorit ekonomik të shpërblyer me kërkesat Dosjes së Tenderit, megjithatë oferta e tij është konsideruar e përgjegjshme dhe është shpërblyer me kontratë, ndërsa oferta jonë është eliminuar nga procedura. Një qasje e tillë krijon përshtypjen se kriteret e vlerësimit nuk janë aplikuar në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Në këto rrethana, vendimi i Autoritetit Kontraktues paraqet cenim të parimit të trajtimit të barabartë dhe mos-diskriminimit, si dhe është në kundërshtim me qëllimin themelor të Ligjit për Prokurimin Publik për sigurimin e konkurrencës së drejtë dhe përdorimin efikas të fondeve publike.

KRITERET PËR VLERËSIM

Dosja e Tenderit - FDT

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(VENDIMI MBI RISHQYRTIM)

Përgjigjet e AQP-së lidhur me pretendimet:

Refuzohen si të pabazuar pretendimet e ankuesit.

Për pretendimin 1, konsiderohet që është e sqaruar qartë në arsyetimin e eliminimit tuaj, pra ju keni dorëzuar ofertë si grup që jeni tre (3) OE ndërsa tek ndarja e punëve keni vetëm dy (2) OE

ndërsa Letra e Referencës e lëshuar nga banka komerciale është për OE-në e tretë i cili njëkohësisht

sipas Deklaratës për themelimin e grupit nuk ka asnjë përgjegjësi për realizimin e kontratës, pra

praktikisht dokumentacioni i dorëzuar nga ju nuk përmbush qëllimin e kërkesës që është për të

pasur një kontraktues i cili ka kapacitete financiare për fillimin dhe mbarimin e kontratës pra që

ka likuiditet me qëllim që të mos rrezikohet në asnjë formë realizimi i kontratës.

Sa i përket interpretimit të KRPP-së 18 i datës 22.11.2022 është përfunduar: "18. 22.11.2022 - ? lejohet

një kompani të mbështet në kapacitetet e degëve të saja, apo duhet të marrë pjesë vetëm si grup

i operatorëve ekonomik?" - Andaj këtu nuk kemi të bëjmë me mbështetje të një OE apo GOE në kapacitetet e një dege të saj.

8

Për pretendimin 2, Vlerësimi është bërë bazuar në dokumentet që keni dorëzuar me ofertën tuaj,

ku nuk keni ndonjë dokument për mjete te gatshme mbi 200,000€ por keni vetëm një dëshmi për

mjetet e gatshme me datën 29.12.2025 ku vlera është më pak se 200,000€ (fundit i asaj dite sipas

dokumentet që keni bashkangjitur ne oferte), ndërsa letra e referencës nga banka është e kushtëzuar

pra ku çeket që do të bëhen vlerësimet për të lëshuar kredi. Dokumenti i ofruar për mjete te gatshme

ne kërkesë për rishqyrtim nuk ka qenë pjesë e ofertës tuaj.

Bazuar në këto informacion konsiderojmë që vlerësimi është kryer në harmoni të plotë me në dhe pretendimet tuaja refuzohen të pabazuar

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - HC STORE SH.P.K.

Pretendimi nr.1

Pretendimi kryesor ankimorë sipas ankesës 163/26 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues nga AK, ku sipas AK-së i njëjti nuk plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për mjete të gatshme në bankë ose qasje të pakushtëzuar në kredi në vlerë 200,000€.

Ak pretendon se :

"Ju jeni eliminuar për arsye : është vlerësuar që nuk ka plotësuar kërkesën administrative lidhur me DEKLARATA PËR THEMELIM TE GRUPIT ku tek pika 5 e kësaj deklarate paraqiten vetëm dy anëtarë te grupit qe kane % (përqindjen) e pjesëmarrjes ne realizimin e kontratës ne raportet 75% me 25%, ndërsa një anëtarë i grupit nuk figuron fare tek përqindja e pjesëmarrjes ne realizimin e kontratës, pra një anëtarë i grupit figuron që nuk ka fare pjesëmarrje në realizimin e kontratës por ka vetëm përgjegjësin siç është cekur në këtë deklaratë citojmë: "Po ashtu N.P.T. AL - VIS (Fehmi Cakiqi B.I.) merre përsipër si anëtar i grupit të nxjerrë letër përkrahëse kredie nga ndonjë bank e licensuar në emër të tenderit të publikuar nga AQP-ja.", me këtë rast në fakt kredia për këtë OE nuk plotëson kushtin për te cilin është kjo kërkesë që është me qellim që kontraktuesi të ketë likuiditet/mjete financiare për fillimin dhe realizimin e kontratës pa probleme. Gjithashtu edhe tek ky OE është vlerësuar që Letra e Referencës nuk plotëson kërkesën e dosjes se tenderit pasi që në të ceket citojmë: "(emri i bankës) do të konsiderojë mbështetjen financiare duke u bazuar në kapacitetin e tij financiare pas analizës financiare të bërë nga analistët tanë të kredive për shumen e kerkuar...", pra përveç që ky dokument është i lëshuar për anëtarin e grupit që nuk pjesëmarrje në realizim të kontratës gjithashtu nuk është e lëshuar sipas kërkesës së dosjes së tenderit ku kërkohet që të jetë qasje e pakushtëzuar. Ndërsa në një dokument tjetër për liderin e grupit është dëshmuar që me datën 29.12.2025 që ka pasur mjete financiare në një vlerë që nuk plotëson kushtin prej minimum 200,000€ siç është kërkuar..."

Ndërsa OE ankues përmes ankesës në OSHP ndër të tjera pretendon se :

"Prandaj, eliminimi për shkak të mungesës së përqindjes operative bie ndesh me nenin 68.4 dhe interpretimin zyrtar të KRPP, pasi përgjegjës për ekzekutimin e kontratës është grupi, dhe jo subjekti pa pjesëmarrje operative. Ne rastin konkret ne permes letres bankare te OE N.P.T. AL-VIS (Fehmi Cakiqi B.I.) kemi dëshmuar për autoritetin kontraktues se do të kemi në dispozicion burimet e nevojshme. Interpretimi zyrtar i KRPP-se nr. 18 të datës 22.11.2022: "Një operator ekonomik mund të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera për përmbushjen e kërkesave financiare ose teknike dhe nuk mund të diskualifikohet pse nuk ka marrë pjesë si grup i operatorëve ekonomik." Gjithashtu është theksuar se: "Është e drejtë e çdo operatori ekonomik të mbështetet në kapacitetet e një subjekti tjetër; dallimi qëndron vetëm tek përgjegjësia për ekzekutimin e kontratës." Prandaj, eliminimi për shkak të mungesës së përqindjes operative bie ndesh me interpretimin zyrtar të autoritetit rregullator, respektivisht KRPP pasi qe edhe sipas interpretimit te KRPP përgjegjës për ekzekutimin e kontratës është operatori ekonomik i cili mbështetet në kapacitetet e subjekteve tjera dhe si rrjedhoje ne kete rast Grup i Operatorëve Ekonomik HC STORE SH.P.K.; MEKA SH.P.K.; eshte pergjegjes per ekzekutimin e kontrates..

Eksperti shqyrtues jep mendim se në pajtim me nenin 68 të LPP-së paragrafi 4, një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështeten në kapacitetet e pjesëmarrësve në grup të subjekteve të tjera.

Në rastin konkret OE Femi Cakiqi është anëtar i grupit të OE ankues (i cili ka ofruar konfirmim nga banka se me 10.02.2026 ka pasur bilancin në dispozicion prej 236,037.62 EUR) dhe grupi mund të mbështet në kapacitet ekonomike të tij.

Në rastin konkret në dosje të tenderit nuk ka qenë e përcaktuar apo e kufizuar përqindja e obligative e pjesëmarrjes për liderin apo anëtarët, dhe pavarësisht se se anëtarit të tretë të OE nuk i është përcaktuar “përqindja e pjesëmarrjes” (fjalë kjo që në vet vete paraqet sfidë pasi nuk ka formulë apo njësi që e përcakton “përqindjen e pjesëmarrjes”), eksperti shqyrtues jep mendim se grupi si tërësi mund të mbështet në kapacitet e anëtarit të grupit.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor është i bazuar dhe se grupi i OE-ve mund të mbështet në kapacitet ekonomike të anëtarit të grupit.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës për lot.5 dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “HC STORE SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me artikuj ushqimor - Lot 3 dhe Lot 5” me numër të prokurimit: “201/26300-25-11214-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Agjencia Qendrore e Prokurimit**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **HC STORE SH.P.K.**

Ilir Halili

